



Datë: 03.06.2025

Numër Protokolli: 3748/2025

A.nr.918/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.918/2025, të datës 20.05.2025, të parashtruar nga ankuesja F.Ll, kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 03.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.918/2025, e datë 20.05.2025, e parashtruar nga ankuesja F.Ll.

A r s y e t i m

Ankuesja F.Ll (*tutje referuar ankuesja*), më datë 20.05.2025, përmes emailit ankesa.kpmsbck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.918/2025, kundër Njoftimit të datës 22.04.2025, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, lidhur me refuzimin e aplikacionit, në procedurën e pranimit nr.Reference: RN00016819, Grupi i dheut dhe ujërave/pozita Zyrtar për Analiza Laboratorike të Ujit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa, kjo e fundit më datë 27.05.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses **është parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se MMPHI, më datë 24.02.2025, ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN00016819, për grupin e dheut dhe ujërave/ pozita Zyrtar për Analiza Laboratorike të Ujit, me afat aplikimi 25.02.2025 deri 26.03.2025.

Tutje, sipas provave të lëndës del se ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs, dhe së të njëjtës sipas Njoftimit të datës 22.04.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MMPHI-së, i është refuzuar aplikacioni më arsyetimin se: *mungon përvoja e punës e kërkuar sipas konkursit sepse edhe pse e keni bashkangjitur pasqyrën e kursimeve pensionale te kontrata e bashkangjitur nuk ka datë të fillimit e as të përfundimit*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton Njoftim e datës 22.04.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MMPHI-së për refuzimin e aplikacionit, duke pretenduar se është në marrëdhënie të rregullt pune nga nëntori i vitit 2022 dhe vazhdoj tutje, dhe kjo përvojë është relevante me pozitën përkatëse, kështu që refuzimi i aplikacionit është i padrejtë. Kërkon që vendimi të rishqyrtohet dhe të mundësohet vazhdimi në fazat tjera të rekrutimit.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 i cili përcakton se: “12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 20.05.2025, kundër refuzimit të aplikacionit është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses të datës 20.05.2025, nuk kishte përfunduar procedura e pranimi sipas konkursit me Nr. Reference: RN00016189, rrjedhë se ankesa e ankuesit A.nr.918/2025, është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.918/2025, nuk mohon të drejtën e ankueses që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.918/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses F.Ll;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.